



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 62, datë 15.02.2024

PËR

MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI, VITI 2023”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një gjyqtari,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një gjyqtari, viti 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

RAPORT VJETOR

MBI

VEPRIMTARINË E KOMISIONIT

TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI, VITI 2023

Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023 (KPSHA), është ngritur dhe ka ushtruar veprimtarinë e tij bazuar në ligjin Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 62, 66-69 të këtij ligji, si dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin Nr. 34, datë 19.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u vendos përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023 (KPSHA), si më poshtë:

1. Z. Ilir Rusi – anëtar;
2. Z. Alban Toro – anëtar;
3. Znj. Irena Plaku – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Znj. Yllka Rupa – anëtar;
2. Z. Klodian Kurushi – anëtar.

Gjatë vitit 2023, në Këshill rezultojnë të jenë depozituar **99** ankesa të reja kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Nga këto **99** ankesa, KPSHA ka trajtuar **74** prej tyre me vendim Komisioni (ku për 73 ankesa është vendosur refuzimi i ankimit, ndërsa për 1 ankesë është vendosur pushimi i ankimit); për **1** ankesë është vendosur me vendim relatori mospranim

ankimi; ndërsa **1** ankesë i është dërguar për kompetencë organit kompetent; ndërsa **23** ankesa për të cilat nuk u bë e mundur shortimi dhe trajtimi i tyre për shkak të kohës së kufizuar, i janë mbartur Komisionit të ri.

Përveç 99 ankesave të regjistruara rishtazi gjatë vitit 2023, Komisioni ka patur për të trajtuar edhe **10** ankesa të mbartura nga viti 2022 dhe **1** ankesë të mbartur nga vit 2021, duke e çuar në **110** numrin total të ankesave që duheshin trajtuar gjatë vitit 2023. Në lidhje me **10** ankesat e mbartura nga viti 2022 rezulton që të gjitha këto ankesa janë trajtuar me vendim Komisioni dhe për to është vendosur refuzimi i ankimit. Ndërsa ankesa e mbartur nga viti 2021 ka ngelur pa u trajtuar dhe si rrjedhojë kjo ankesë i është mbartur Komisionit të ri. Në lidhje me këtë ankesë të mbartur nga viti 2021 rezulton se është regjistruar pranë KLGJ-së më datë 01.12.2021 dhe nuk u arrit të trajtohej nga Komisioni i vitit 2021. Si rrjedhojë, iu mbart Komisionit të vitit 2022, ku me shortin e datës 02.02.2022 i ka kaluar për trajtim relatores znj. Fatmira Luli. Duke qenë se nuk u trajtua nga Komisioni gjatë vitit 2022, iu mbart Komisionit të ri në vitin 2023 dhe me shortin e datës 26.01.2023 i kaloi për trajtim relatorit z. Ilir Rusi.

Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur rezulton se gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej **110** ankesa (10 të mbartura nga viti 2022; 1 e mbartur nga viti 2021 dhe 99 të regjistruara në viti 2023). Komisioni gjatë vitit 2023 ka zhvilluar **11** mbledhje në të cilat ka trajtuar **84 ankesa** (10 nga viti 2022 vendosur refuzimi + 74 nga viti 2023 ku për 73 ankesa vendosur refuzimi, ndërsa për 1 ankesë vendosur pushimi i ankimit); për **1** ankesë (e regjistruar gjatë vitit 2023) është marrë vendim mospranim ankimi nga relatori; **1** ankesë (e regjistruar gjatë vitit 2023) është dërguar për kompetencë organit kompetent; si dhe **24** ankesa (23 të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 1 e regjistruar gjatë vitit 2021) kanë ngelur pa u trajtuar duke iu mbartur në këtë mënyrë Komisionit të ri.